



Simboli i Komunës

SHTYPI DITOR PËR SUHAREKË

BOTA SOT**KOHA DITORE****ZËRI****PRISHTINA POST****KOSOVA SOT****LAJMI****EXPRESS**

**Foto Lajm nga
Theranda**



Kosova sot, fq 8
E shtunë, 18 shtator2010

Therandë: Sivjet, 18 shkurorëzime

Si në të gjithë Kosovën, edhe në komunën e Suharekës, pas luftës dukuria e shkurorëzimeve ka shënuar rritje dhe shkaktarët e këtij fenomeni janë të ndryshëm. Nuk janë të rralla edhe prishjet e shkurorëzimeve me marrëveshje, kur meshkujt emigrojnë në botën e jashtme dhe lidhin kurorë, siç po thuhet “për letra” me gra të huaja sa për të siguruar vizën dhe një vend pune...

Autor: Rahman Rexhaj

Prishtina post, fq 10

Edhe një donacion për shkollën fillore “7 Marsi”

Pas donacionit të qeverisë japoneze në shumë prej 60 mijë euro për nevojat e nxënësve të shkollës fillore “7 Marsi” të Thernadës, në adresë të kësaj shkolle ka arritur edhe donacioni tjetër nga inxhi. Julian Zaug nga Franca, i cili vizitoi këtë shkollë dhe djelli edhe 20 kompjuterë komplet për instalimin e kabinetit të informatikës...

Autor : Sami Rakaqi

Prishtina post, fq 11

Vazhdon zhvillimi i infrastrukturës

Qeveria komunale e Therandës është duke u angazhuar me të madhe, që me ndërtimin e infrastrukturës rrugore të u mundëson lidhje më të mira në mes të fshatrave të kësaj komune. Kështu kjo qeveri tashmë po u jep prioritet lokaliteteve të kësaj komune që në të kaluarën nuk kanë pas investime dhe kanë mbetur mbrapa sa i takon infrastrukturës rrugore...

Autor : Sami Rakaqi

Prishtina post, fq 34

Ballkani do të angazhohet për rezultat sa më të favorshëm

Në xhiron e shtatë të Raiffeissen Supeligës futbollistike të Kosovës, ku Në Gjakovë do të takohen Vëllaznimi dhe Ballkani i Therandës, do të jetë një lojë shumë e fortë ku të dy rivalët do të angazhohen për fitore. Therandasit të cilët në dy xhirot e para korrën dy fitore, pastaj pësuan një humbje dhe në vazhdim arritën tri barazime, sikur fati po ua kthen shpinën, andaj në takim me gjakovarët ata do të angazhohen që të lajnë lojën e tyre dhe mos të kthehen duarthatë, por vështirë e kanë pasi Vëllaznimi si nikoqir vështirë humbet kur dihet se edhe ky ekip ka atutet e veta, thotë kryetrajnieri Adil Vokrii....

Autor : Sami Rakaqi



Simboli i Komunës

SHTYPI DITOR PËR SUHAREKË

BOTA SOT**KOHA DITORE****ZËRI****PRISHTINA POST****KOSOVA SOT****LAJM****EXPRESS**

Zëri, fq 14

Kuçi paralajmëron përmirësim të infrastrukturës rrugore

Ndër prioritetet që ka përcaktuar komuna e Therandës kur është fjala për përmirësimin e infrastrukturës lokale janë lidhjet me rrugë të asfaltuara të fshatrave në mes veti. Këtë e ka thënë kryetari i kësaj komune, Blerim Kuçi, duke shtuar se krahas këtij prioriteti, rëndësi do t'i kushtohet edhe rrugëve rajonale që lidhin komunën e Therandës me komunat fqinje...

Autor : Refki Reshitaj

Bota sot, fq 39

Njoftim për dhënie të kontratës

Titulli i kontaktës i dhënë nga autoriteti kontraktues : “Ndërtimi i QMF-së në fshatin Leshan”

Data e dhënies së kontratës me 17.09.2010

Emri dhe adresa e operatorit ekonomik të cilit i është dhënë kontrata: NNP “FERBAING”- Suharekë

Vlera e përgjithshme përfundimtare e kontratës 38,163,31 €

**Foto Lajm nga
Theranda**

